



Prishtinë, më 23 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1143/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI37/17 dhe KI52/17

Parashtrues

**Tihomir Mikarić
Olga Janićijević
Shemsije Sheholli**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. Kzz 236/2016,
të 11 janarit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI37/17 është dorëzuar nga Tihomir Mikarić, me banim në Laplje Selo, komuna e Graqanicës, dhe Olga Janićijević, me banim në Prishtinë; kërkesa KI52/17 është dorëzuar nga Shemsije Sheholli, me banim në Prishtinë (në tekstin e mëtejshmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kérkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml. Kzz 236/16, të 11 janarit 2017 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR 158/15, të 5 prillit 2016 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, K. nr. 272/13, të 9 shtatorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kérkesës, të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 (2) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Neni 33 (1) (4) [Parimi i Ligjshmërisë dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], neni 107 [Imuniteti] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).
4. Parashtruesja e kérkesës Shemsije Sheholli kérkoi nga Gjkata që të mbajë seancë dëgjimore.

Baza juridike

5. Kérkesat bazohen në nenin 113. 7 të Kushtetutës, në nenin 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 prill 2017, parashtruesit e kérkesës Tihomir Mikarić dhe Olga Janićević e dorëzuan kérkesën e tyre KI37/17 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjkata).
7. Më 7 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gérxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 21 prill 2017, parashtruesja e kérkesës Shemsije Sheholli e dorëzoi kérkesën KI52/17 në Gjykatë.
9. Më 24 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kérkesave sipas rregullit 37 (1) të Rregullores së punës.
10. Më 25 maj 2017, Gjkata njoftoi parashtruesit për regjistrimin dhe bashkimin e kérkesave të tyre dhe dërgoi një kopje të kérkesave në Gjykatën Supreme.

11. Më 12 qershor 2017, parashtruesja e kërkesës Shemsije Sheholli dorëzoi dokumente shtesë dhe kërkoi nga Gjykata të mbajë seancë dëgjimore dhe t'i mundësojë asaj të marrë pjesë në atë seancë.
12. Më 7 shtator 2017, Kolegji shqyrtiesh shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përbledhja e fakteve

13. Më 27 korrik 2012, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ngriti aktakuzën PPS 253/09 kundër parashtruesve të kërkesës.
14. Më 9 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prizren (Aktgjykimi P. nr. 272/13) shpalli fajtor:
 - (i) parashtruesin e kërkesës Tihomir Mikarić sepse ndërmjet vitit 2006 dhe 2007, si gjyqtar në Gjykatën e atëhershme Komunale në Prishtinë, mori vendime të kundërligjshme në rastet nr. 1908/03; 342/06; dhe 1918/06;
 - (ii) parashtruesen e kërkesës Olga Janićijević sepse ndërmjet vitit 2006 dhe 2007, si gjyqtare në Gjykatën e atëhershme Komunale në Prishtinë, mori vendime të kundërligjshme në rastet nr. 1314/07; 53/06; 3/06; 1849/06; 1147/06; 3521/04; 1415/05; 1738-/07; dhe,
 - (iii) parashtruesen e kërkesës Shemsije Sheholli sepse ndërmjet vitit 2006 dhe 2007, si gjyqtare në Gjykatën e atëhershme Komunale në Prishtinë, mori vendime të kundërligjshme në rastin nr. 2333/05.
15. Gjykata Themelore shpalli parashtruesit e kërkesës fajtorë për shkak të kryerjes së veprës penale "Nxjerra e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore" siç parashihet me nenin 346 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/REG/2003/25 (në tekstin e mëtejmë: KPPK), i 6 korrikut 2003. Gjykata Themelore arsyetoit se parashtruesit e kërkesave kanë marrë vendime lidhur me pretendimet pronësore kundër ndërmarrjeve shoqërore në kundërshtim me ligjin në fuqi, i cili parashev që Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme ka juridikcion parësor për zgjidhjen e këtyre kërkesave. Gjykata Themelore, më tej, shtoi se parashtruesit e kërkesës i kanë marrë këto vendime për qëllime të fitimit material personal dhe për fitimin material të personave të tretë.
16. Parashtruesi i kërkesës Tihomir Mikarić u dënuat me 1 (një) vit burgim me kusht, i cili nuk do të ekzekutohet me kusht që të mos kryejë vepër tjetër penale brenda një periudhe 2 (dy) vjeçare. Parashtruesja e kërkesës Olga Janićijević u dënuat me 18 (tetëmbëdhjetë) muaj burgim me kusht, i cili nuk do të ekzekutohet me kusht që të mos kryejë vepër tjetër penale brenda një periudhe 2 (dy) vjeçare. Parashtruesja e kërkesës Shemsije Sheholli u dënuat me 8 (tetë) muaj burgim me kusht, i cili nuk do të ekzekutohet me kusht që të mos kryejë vepër tjetër penale brenda një periudhe 2 (dy) vjeçare.
17. Gjykata Themelore, sipas nenit 54 [Dënimet plotësuese] dhe nenit 57 [Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës] të KPPK-së, i dënoi

parashtruesit e kérkesës me dënim plotësues të ndalimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

18. Parashtruesit e kérkesës parashtruan ankesë pranë Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendim përsanksionin penal.
19. Më 5 prill 2016, Gjkata e Apelit (Aktgjykimi PAKR 158/15) aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesve të kérkesës, në atë masë sa qëllimi i tyre për të përfituar dobi materiale të paligjshme nuk mund të vërtetohej përtej një dyshimi të arsyeshëm dhe dënimini plotësues i shqiptuar ishte shumë i paqartë; refuzoi si të pabazuar pjesën e mbetur të ankesës; dhe vërtetoi dënimet e tyre.
20. Parashtruesit e kérkesës parashtruan kérkesë për mbrojtje të ligshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre themelore të njeriut, që kryesisht konsistonin në pretendimet për drejtësi selektive, formën dhe përbajtjen e aktgjykimeve, disproporcionaliteti në rastet penale, vërtetimin e qëllimit penal, vërtetimin e fakteve, provave të falsifikuara, imunitetin e gjyqtarëve dhe shqiptimin e gabuar të dënimit plotësues.
21. Më 11 janar 2017, Gjkata Supreme (Aktgjykimi Pml. Kzz 236/2016) hodhi poshtë si të pabazuar kérkesën e parashtruesve për mbrojtje të ligshmërisë, sepse konkludoi se “*të gjitha pretendimet kundër formës dhe përbajtjes së aktgjykimit të Gjykatës së Apelit ishin të pabazuara (...)*”.

Pretendimet e parashtruesit të kérkesës

22. Parashtruesit e kérkesës pretendojnë shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 2, të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafët (1) dhe (4), të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenit 107 [Imuniteti] të Kushtetutës në lidhje me paragrin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).
23. Parashtruesit e kérkesës Tihomir Mikarić dhe Olga Janićijević pretendojnë se procedurat ishin arbitrale. Në të vërtetë, ata pretendojnë se “*Aktgjykimi i shkallës së parë (...) është arbitrar, hipotetik dhe i pakuptueshëm. Në paragrin 267 të arsyetimit të aktgjykimit thuhet: “Kolegji e shqyrtoi Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13, në veçanti nenin 4 dhe vërtetoi se dispozitat janë të qarta. Megjithatë, Kolegji nuk e ka lexuar Rregulloren”.*
24. Parashtruesit e kérkesës Tihomir Mikarić dhe Olga Janićijević, gjithashtu, pretendojnë se aktgjykimet e gjykatave tregojnë arsyetim të mangët. Në të vërtetë, ata pohojnë se “*Gjkata Themelore në Prizren, si gjykatë e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsyë të mjaftueshme për aktgjykimin e saj. Ajo nuk e arsyetoi në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje fajin tim, as dashjen time, si elementin themelor të veprës penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, të parashikuar me nenin 346 të KPPK-së”.*

25. Përveç kësaj, parashtruesit e kérkesës Tihomir Mikarić dhe Olga Janićijević pretendojnë shkelje të nenit 31 (2) të Kushtetutës. Në të vërtetë, ata pretendojnë se “*Aktgjykimi i shkallës së parë është nxjerrë jashtë afatit të arsyeshëm prej 180 ditësh, i cili është i nevojshëm për nxjerrjen e vendimit gjyqësor. PSRK e ka ngritur, më datën 27.07.2012, aktakuzën PPS 253, të datës 19.07.2012, ndërsa aktgjykimi është nxjerrë më datën 09.09.2014*”.
26. Parashtruesit e kérkesës Tihomir Mikarić dhe Olga Janićijević i paraqesin më tej arsyet e përmendura në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Në të vërtetë, ata pretendojnë se “*gjykata e shkallës së dytë (...) nuk ka dhënë arsyetë vlefshme se në çfarë mënyre ka vërtetuar se unë i kam nxjerrë aktgjykimet e kontestuara gjoja me qëllim që të dëmtoj NSH KBI “Kosovo-Export” (...). Aktgjykimi i shkallës së dytë, gjithashtu nuk mund t'i përbush standartet e vendimit të arsyetuar, me të cilin do të ishte respektuar e drejta ime për një vendim të arsyetuar, ashtu siç është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.
27. Përveç kësaj, parashtruesit e kérkesës Tihomir Mikarić dhe Olga Janićijević pretendojnë shkelje të nenit 33 (1) dhe (4) të Kushtetutës. Në të vërtetë, ata pretendojnë se “*Gjykata Supreme (...) justifikoi aktgjykimet e paligjshme dhe të padrejta të gjykatave më të ulëta, duke sajuar “dashjen specifike”, e cila dallon nga format themelore të dashjes të përcaktuara në nenin 15 të KPK-së, dhe në këtë mënyrë e ka shkelur drejtpërdrejtë nenin 33, paragrafi 1 dhe paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (...)*”.
28. Në fund, parashtruesit e kérkesës Tihomir Mikarić dhe Olga Janićijević kérkojnë nga Gjykata: (i) të konfirmojë shkeljen e nenit 31 (2) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së; (ii) të konfirmojë shkeljen e nenit 33 (1) dhe (4) të Kushtetutës; dhe (iii) të shpallin të pavlefshme të gjitha aktgjykimet e gjykatave të rregullta.
29. Parashtruesja e kérkesës Shemsije Sheholli pretendon falsifikim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren. Në fakt, ajo pretendon se “*(...) gjykata e shkallës së parë - ka bërë fshehjen e dokumenteve provave materiale në dëm timin të cilat gjinden në shkresat e lëndës P.nr. 272/13. Kjo provë materiale qëllimisht është fshehur në dëm timin nga Kryetari i Trupit Gjykues (...)*”.
30. Parashtruesja e kérkesës Shemsije Sheholli gjithashtu flet për konsistencën e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Në fakt, ajo pretendon se “*(...) mua si gjyqtare të shkallës së parë më shpallo fajtore - ndërsa Trupin Gjykues të Gjykatës së Qarkut që e kanë vërtetuar këtë Aktgjykimin të cilin e kam nxjerrë unë si Kryetare e Trupit gjykues në shkallë të parë i liron nga çdo akuzë*”.
31. Parashtruesja e kérkesës Shemsije Sheholli më tej ankohet ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Supreme “*(...) që kérkesën time për mbrojtjen e ligjshmërisë (...) e refuzon si të pabazuar - pa asnë bazë ligjore*”.
32. Përveç kësaj, parashtruesja e kérkesës Shemsije Sheholli pretendon shkelje të nenit 107 të Kushtetutës. Në të vërtetë, ajo pretendon se “*(...) jam shpallo fajtore për veprën penale (...) dhe jam dënuar me dënim me kusht (...), Gjykata e Apelit në Prishtinë e ka refuzuar ankesën time, dhe në raport me mua e ka*

vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren. Të dy aktgjykimet janë marrë me një varg shkeljesh të dispozitave edhe formale edhe materiale. Madje, me këto aktgjykime është shkelë edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës (...).

33. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës Shemsije Sheholli pretendon se ajo është viktimi e diskriminimit nga gjykatat, sepse: (i) në procedurën para gjykatës së faktit, provat ishin "manipuluar" dhe dokumentet ishin "fshehur" në dëm të saj; (ii) qëllimi i saj për të kryer vepër penale dhe qëllimi i saj për përfitim material nuk janë vërtetuar kurrë dhe për këtë arsy, në mungesë të elementeve të tilla, nuk ka vepër penale; dhe (iii) dënim i plotësues, përkatesisht ndalimi i ushtrimit të profesionit të saj si gjyqtare është "i paligjshëm", "i padrejtë" dhe "denigrues" për të si gjyqtare dhe se ky dënim "seriozisht" shkel nenin 107 të Kushtetutës.
34. Në fund, parashtruesja e kërkesës Shemsije Sheholli kërkon nga Gjykata që t'i shpallë të pavlefshme të gjitha aktgjykimet e gjykatave të rregullta.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
36. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksiuni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*
37. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor."

38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës janë individë të cilët pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë nga gjykatat e rregullta; ata kanë dorëzuar kërkesat e tyre brenda afatit të paraparë dhe kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion.
39. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parashesh se:

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

40. Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d), i cili parasheh:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
 (...)
 (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar*
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
 (...)
 (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
41. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara, se i kanë parashtruar kërkesat e tyre në afatin e paraparë dhe i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike. Megjithatë, parashtruesit e kërkesës nuk kanë mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tyre, siç do të shpjegohet më tutje.
42. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 3, 24, 31 (2), nenit 33 (1) dhe (4), 54 dhe 107 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
43. Gjykata rikujton nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gjëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”
 (...)”*
44. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, përcakton:
- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gjëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*
45. Përveç kësaj, nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, parasheh:
- “1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.”*

46. Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, përcakton që:

“1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënин gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerezimit.

[...]

4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.”

47. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, parasheh që:

“Cdokush gjëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

48. Neni 107 [Imuniteti] i Kushtetutës, përcakton:

1. Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gjëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”.

49. Gjkata në fillim vëren se parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e njëjtë të Gjykatës Supreme; megjithatë, disa nga pretendimet janë ngritur nga më shumë se një prej parashtruesve të kërkesës. Prandaj, Gjkata do t'i shqyrtojë ato së bashku ose një nga një për aq sa ato janë të ndërlidhura ose të ndara.
50. Në këtë drejtim, Gjkata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre, përkatësisht argumentojnë drejtësinë selektive, formën dhe përmbajtjen e vendimeve, disproporcionalitetin në rastet penale, krijimin e qëllimit penal, vërtetimin e fakteve, dëshmitë e falsikuara, privimin e imunitetit të gjyqtarëve dhe shqiptimin e gabuar të dënimit plotësues.
51. Gjkata konsideron se këto pretendime dhe argumete tashmë ishin bazë për të cilën parashtruesit kerkuan mbrojtjen e ligjshmërisë.
52. Në të vërtetë, Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës Tihomir Mikarić kerkoi mbrojtjen e ligjshmërisë, duke argumentuar se “*aktgjykimet janë në shkelje të nenit 346 [Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore] të KPPK dhe në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 (1.3) të KPP-së*”.

53. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja e kërkesës Olga Janićjević kerkoi mbrojtje të ligjshmërisë, duke argumentuar se “*aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me nenin 346 të KPPK-së, sepse në arsyetim nuk përmendet asnje provë që vërteton se ajo kishte pasur për qëllim të shkaktojë dëm*”.
54. Gjykata më tej vëren se parashtruesja e kërkesës Shemsije Sheholli kerkoi mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar se “*aktgjykimet janë në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale, të ligjit penal dhe të Kushtetutës*”. Në lidhje me atë shkelje të pretenduar të Kushtetutës, parashtruesja Shemsije Sheholli pretendon se “*aktgjykimet shkelin parimin e mbrojtur me Kushtetutë të imunititetit për gjyqtarët, në pajtim me nenin 107 të Kushtetutës, pasi e privojnë një gjyqtar nga e drejta për të nxjerrë aktgjykime të pavarura në bazë të ligjit të zbatueshëm*”.
55. Gjykata konsideron se pretendimet dhe argumentet e ngritura në Gjykatë janë në lidhje me gabimet e fakteve dhe ligjit që pretendohen të janë kryer jo vetëm nga Gjykata Supreme, por edhe nga Gjykata e Apelit, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Komunale. Pretendimet dhe argumentet e marra nga parashtruesit e kërkesës janë të njëjtë në thelb si ato të paraqitura në Gjykatën Supreme. Duket se parashtruesit e kërkesës paraqiten në Gjykatën Kushtetuese, si të ishte një gjykatë e “shkallës së katërt”.
56. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të janë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend se një tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të ishte mosmarrje parasysh e kufijve të vendosur në juridikcionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Kërkesa nr. 30544/96, paragrafi 28; dhe shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 gushtit 2016, paragrafi 40).
57. Gjykata thekson se, si rregull i përgjithshëm, vërtetimi i fakteve dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit është ekskluzivisht çështje e gjykatave të rregullta, të gjeturat dhe konkluzionet e të cilave në këtë drejtim janë detyruar për Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, kur vendimi i gjykatës së rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta shqyrtojë atë (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI63/16, *Ibidem*, paragrafi 45).
58. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka analizuar hollësisht pretendimet dhe argumentet në kërkesën e parashtruesve për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ka dhënë përgjigje të arsyetuara. Gjykata Supreme në mënyrë të veçantë analizoi dhe vendosi për argumentet e krijimit të dashjes, “drejtësisë selektive”, seancën e mbajtur më 3 shtator 2014, provat e falsifikuara, imunitetin, formën dhe përbajtjen e aktgjykimeve dhe shqiptimin e dënimive plotësuese.

59. Në të vërtetë, sa i përket pretendimit të parashtruesve për drejtësi selektive, Gjykata Supreme theksoi se “*argumentet në lidhje me këtë janë jashtëzakonish të paqarta pasi ato nuk janë të vërtetuara me asnje bazë ligjore*”. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konsideroi se “*nuk është shkelje as e ligjit tē procedurës penale dhe as e ligjit penal tē lirojë vetëm disa nga tē pandehurit bazuar në një vlerësim tjetër tē fakteve tē vërtetuara*”. Përfundimisht, Gjykata Supreme “*nuk ka gjetur se (...) ligji me qëllim është aplikuar në mënyrë selektive. Për shkak tē kësaj, akuzat janë tē pabazuara*”.
60. Sa i përket pretendimit të parashtruesve tē kërkesës në lidhje me formën dhe përbajtjen e aktgjykimeve tē gjykatave tē shkallës më tē ulët, Gjykata Supreme theksoi se “*Gjykata e Apelit konfirmoi konkluzonet tashmë tē shtjelluara gjerësisht nga Gjykata e Qarkut*”. Gjykata Supreme konsideroi se, “*Në situatat kur Gjykata e Apelit pajtohet me arsyet e dhëna në shkallë tē parë, standardi pér arsyetimin e tij është në nivel më tē ulët. Kolegji nuk pajtohet që arsyetimi është i pamjaftueshëm ose se dispozitivi është i paqartë ose i pakuptueshëm*”. Në fund, Gjykata Supreme konstatoi se “*të gjitha pretendimet kundër formës dhe përbajtjes së aktgjykimit tē Gjykatës së Apelit janë tē pabazuara në këto pjesë*”.
61. Sa i përket pretendimit të parashtruesve për ushtrimin e proporcionalitetit nga gjykatat e shkallës më tē ulët, Gjykata Supreme vlerësoi se “*vepra penale e nxjerrjes së kundërligjshme tē vendimeve gjyqësore është në pajtim me nenin 346 tē KPPK-së e dënueshme me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet*”. Gjykata Supreme konsideroi se “*të gjitha kohëzgjatjet e burgimit ishin vendosur brenda kësaj shkalle*”. Përfundimisht, Gjykata Supreme gjeti se “*pér këtë arsy pretendimi që gjykatat i tejkalojnë kompetencat e tyre është i pabazuar*”.
62. Sa i përket pretendimit të parashtruesve tē kërkesës se gjykatat e shkallës më tē ulët nuk e kanë vërtetuar kurrë qëllimin e tyre penal, Gjykata Supreme vlerësoi se “*dashja e paraparë në nenin 346 tē KPPK është një nga elementet specifike tē veprës penale tē nxjerrjes së kundërligjshme tē vendimeve gjyqësore. Është një dashje specifike dhe si e tillë ndryshon nga format themelore tē dashjeve tē parapara me nenin 15 tē KPPK. Neni 15 i KPPK-së përcakton dy llojet e dashjes themelore - tē drejtpërdrejtë dhe tē mundshëm - që vlejnë pér secilën vepër penale në KPPK*”. Gjykata Supreme konsideroi se “*vërtetimi i fakteve në lidhje me elementin specifik subjektiv siç përcaktohet në nenin 346 tē KPPK-së nuk dallon nga vërtetimi i fakteve në lidhje me elementët e tjera*”. Përfundimisht, Gjykata Supreme gjeti se “*prandaj, dashja specifike mund tē dëshmohet në shumë mënyra, duke përfshirë edhe përmes konkluzioneve logjike që mund tē nxirren nga prova tē tjera, duke përfshirë dëshmi rrethanore*”.
63. Sa i përket kërkesës së parashtruesit Tihomir Mikarić se Gjykata Supreme duhet tē shqyrtojë video dhe audio-incizimet, Gjykata Supreme rikujtoi se procedura e kërkesës pér mbrojtjen e ligjshmërisë “*rregullohet me nenet 418 dhe 432-441 tē KPP*”. Gjykata Supreme konsideroi se “*asnje nga këto nene nuk përfshin një mundësi procedurale që Gjykata Supreme tē marrë prova tē reja ose tē shqyrtojë video dhe audio incizimet nga seancat e Gjykatës së Qarkut*”. Përfundimisht, Gjykata Supreme konstatoi se “*pér këtë arsy kërkesa e Tihomir Mikariçit është refuzuar*”.

64. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës Tihomir Mikarić dhe Olga Janićjević se aktgjykimi i shkallës së parë është nxjerrë përtej afatit të arsyeshëm prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, dhe se kjo ka rezultuar në shkelje të paragrafit 2, të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vëren se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se kjo çështje është ngritur nga parashtruesit e kërkesës gjatë rrjedhës së procedurës së rregullt. Kjo çështje është ngritur për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, nuk mund ta vlerësojë këtë çështje pa qenë paraprakisht e ngritur dhe vlerësuar në procedurë të rregullt (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI89/15, parashtrues i kërkesës *Fatmir Koci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 marsit 2016, parografi 35).
65. Sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës Shemsije Sheholli për dëshmi të falsifikuara, Gjykata Supreme konsideroi se “*pretendimi në këtë drejtim është i paqartë pasi nuk mbështetet në asnjë bazë apo shembull ligjor*”. Përveç kësaj, Gjykata Supreme vërejti se “*nuk mund të vlerësojë vërtetimin e fakteve të Gjykatës së Qarkut, pasi neni 432 (2) i KPP ndalon argumentet që - në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë vënë në pyetje vlerësimin e fakteve*”. Përfundimisht, Gjykata Supreme konkludoi se “*nuk gjeti ndonjë indikacion se gjykatat kanë falsifikuar provat, këto pohime janë të pabazuara*”.
66. Sa i përket pretendimit të parashtrueses Shemsije Sheholli për shkeljen e imunitetit të saj si gjyqtare, Gjykata Supreme rikujtoi se: “*neni 107 (2) i Kushtetutës parasheh që gjyqtarët nuk gjëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni, kur të kenë shkelur ligjin me qëllim*”. Gjykata Supreme vërejti se, “*në këtë rast, të pandehurit janë shpallur fajtor për shkelje të qëllimshme të ligjit*”. Në fund, Gjykata Supreme konkludoi se: “*Për këtë arsy, Kushtetuta nuk e përjashton përgjegjësinë penale. Prandaj, pretendimi se Kushtetuta është shkelur është i pabazuar*”.
67. Sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës Shemsije Sheholli për shqiptimin e gabuar të dënimit plotësues, Gjykata Supreme rikujtoi se dënimini plotësues “*sipas nenit 57 të KPPK-së mund të shqiptohet kundër kryesit të veprës penale nëse ai person e ka keqpërdoruar pozitën e tij, veprimtarinë apo detyrën e tij me qëllim të kryerjes së veprës penale ose nëse me arsy mund të pritet se ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale*”. Gjykata Supreme vëren se “*dispozita nuk bën dallim në mes të pandehurve që janë gjyqtarë dhe të pandehurve të tjerë*”. Gjykata Supreme konsideroi se “*në këtë rast, të pandehurit kanë keqpërdorur qartë pozitat e tyre në mënyrë që të kryejnë veprat penale në fjalë*”. Në fund, Gjykata Supreme arriti në përfundimin se “*pretendimi se shqiptimi i dënimit plotësues është i paligjshëm, është i pabazuar*”.
68. Në bazë të shqyrtimeve të mësipërme, Gjykata vëren se parashtruesve të kërkesës u është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ata kishin mundësi që të paraqesin argumete që ata i konsideronin relevante për rastin e tyre në fazat e ndryshme të këtyre procedurave; atyre u është dhënë mundësia që të kontestojnë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga prokurori; dhe se të gjitha

argumentet që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tyre janë dëgjuar e shqyrtuar nga gjykatat e rregullta; se arsyet faktike e ligjore ndaj aktgjykimeve të kontestuara ishin shtruar hollësish, dhe rrjedhimisht, në pajtim me rrrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, procedurat ishin të drejta (Shih, për shembull, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; dhe shih, *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI42/16, Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 40).

69. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kushti i “drejtësisë” siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës mbulon procedurat në tërësi, dhe çështja nëse një person ka pasur një gjykim “të drejtë” shikohet me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo thjesht një incident i veçantë ose mangësi procedurale, dhe si rezultat, mangësitë në një fazë mund të korrigohen në një fazë të mëvonshme (shih, për shembull, rasti i GJEDNJ *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 9562/81; 9818/82, Aktgjykim i 2 marsit 1987, paragrafët 55-70).
70. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, përkatësisht me mënyrën se si ligji është interpretuar dhe zbatuar nga gjykatat. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës së krijuar të GJEDNJ, e cila konstaton se: “*Si pasojë e parimit që ligjet duhet të janë të zbatimit të përgjithshëm, formulimi i statuteve nuk është gjithmonë i saktë. Një nga teknikat standarde të rregullimit sipas rregullave është që të përdoren kategorizime të përgjithshme në krahasim me listat shteruese. Kjo do të thotë se shumë ligje janë në mënyrë të pashmangshme të formuluara në atë mënyrë, që në një masë më të madhe ose më të vogël, janë të paqarta dhe interpretimi dhe zbatimi i tyre varen nga praktika*”. Rrjedhimisht, në çdo sistem të së drejtës, sado që është hartuar një dispozitë ligjore në mënyrë të qartë, duke përfshirë një dispozitë të ligjit penal, ekziston një element i pashmangshëm i interpretimit gjyqësor. Gjithmonë do të ketë nevojë për sqarimin e pikave të dyshimita dhe për përshtatjen me rrrethanat në ndryshim. Roli i gjykimit të dhënë në gjykata është pikërisht që të zhduken dyshimet e tillë interpretuese që mbeten. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ *Scoppola kundër Italise*, Kërkesa nr. 10249/03, Aktgjyki i 17 dhjetorit 2009, paragrafët 100-101).
71. Përveç kësaj, nuk i takon Gjykatës të spekulojë lidhur me vërtetimin e fakteve, interpretimin dhe zbatimin e ligjit penal dhe të procedurës penale nga Gjykata Supreme dhe nga gjykatat e tjera gjatë rrjedhës së procedurës penale.
72. Gjykata thekson që ajo vendos për karakterizimin që duhet t'i jepet me ligj fakteve të rastit, prandaj nuk e konsideron veten të detyruar nga karakterizimi i dhënë nga parashtruesit ose palët e tjera në procedurë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Guerra dhe të tjerët kundër Italise*, Kërkesa nr. 116/1996/735/932, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 44).
73. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar dhe dëshmuan ndonjë shkelje që mund ta çojë Gjykatën në përfundimin se Gjykata Supreme ose gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrale ose të paarsyeshme gjatë vërtetimit të fakteve ose interpretimit të ligjit. (Shih, për shembull, rasti i

GJEDNJ-së, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 7 shkurtit 2012, paragrafi 176).

74. Përveç kësaj, Gjkata konsideron se mospajtimi i parashtruesve me rezultatin e rasteve të tyre nuk mund të ngre vetveti një pretendim të argumentueshëm për shkelje të të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, rasti i Gjkatës Kushtetuese nr. KI63/16, *Ibidem*, paragrafi 46).
75. Bazuar në shqyrtimet e mësipërme, Gjkata konklidon se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur asnjë fakt për të arsyetuar pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me Kushtetutë; dhe as nuk i kanë vërtetuar këto pretendime siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
76. Gjkata konstaton se kërkesat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të shpalen të papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113 (7) të Kushtetutës, parashihet në nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

Kërkesa e parashtrueses Shemsije Sheholli që të mbahet një seancë dëgjimore

77. Gjkata rikujton që parashtruesja e kërkesës Shemsije Sheholli kërkoi të mbahet një seancë dëgjimore dhe t'i mundësohet asaj që të marrë pjesë në atë seancë dëgjimore.
 1. *Gjkata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal*
 2. *Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij nenit, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.*
78. Në lidhje me këtë, Gjkata i referohet nenit 20 të Ligjit, i cili parashev:
 1. *Gjkata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal*
 2. *Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij nenit, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.*
79. Gjkata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk është thirrur në ndonjë arsy për ta mbështetur kërkesën e saj.
80. Prandaj, Gjkata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast sipas formulimit të nenit 20 paragrafi 2 të Ligjit. (Shih, *mutatis mutandis*, Gjkata Kushtetuese rasti nr. KI34/17 parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 12 qershorit 2017, paragrafët 108-110).
81. Prandaj, kërkesa e parashtrueses për mbajtjen e seancës dëgjimore refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (d), dhe 56 (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

